



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Primiher/Prodato Received/Delivered	23.03	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SIJAMBHCK	2943/2023		114	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.345/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.345/2023 të datës 10.02.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Enver Haradinaj", nr.19 në Komunën e Prizrenit, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.345/2023 e datës 10.02.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen për vitin 2022 i datës 18.01.2023.

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit me Nr.01-112-152940 të datës 31.10.2019 në pozitën *Zyrtare për shërbime sociale në kuadër të Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale/Komuna e Prizrenit*, me datën 10.02.2023, ka parashtruar ankesën me numër protokolli 1670/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.02.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit me datën 15.03.2023 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1670/2023 e datës 10.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022 i datës 11.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022 i datës 15.01.2023; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.03.2023 nga Komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Shkresën zyrtare të datës 14.03.2023 nga Drejtoresha e QPS-së në Prizren; Njoftimin e datës 04.01.2023 nga QPS në Prizren; Akt emërimit të ankueses me Nr.01-112-152940 të datës 31.10.2019; Vendimin me Nr.01-130-4295 të datës 11.01.202 lidhur me pushimin pa pagesë; Raportin mjekësor për ankuesen të datës 24.01.2023 E-mailin zyrtar të datës 04.01.2023; E-mailat zyrtar të datës 13.03.2023; 26.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022 i datës 16.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2020 i datës 25.01.2021; Planin individual të trajnimit për vitin 2021 i datës 22.01.2021 për ankuesen; Dëshminë për pushimin mjekësor të datës 11.08.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushim vjetor të datës 16.08.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushimin mjekësor të datës 05.09.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushim vjetor të datës 06.09.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushim vjetor të datës 03.10.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushimin mjekësor të datës 15.11.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushim vjetor të datës 06.12.2022 për ankuesen; Dëshminë për pushimin mjekësor të datës 30.12.2022 për ankuesen; Kërkesat për pushim vjetor të ankueses të datës 24.05.2021, 14.01.2021; Raportet për zgjatjen e paaftësisë së përkohshme -pengesës për punë për datat 30.11.2021, 29.12.2021, 30.12.2021 për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes që lidhen me objektin e kësaj ankesë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularëve për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 të datës 13.01.2023 dhe 15.01.2023, pretendon që vlerësimi është bërë me nota të ndryshme tek dy formularët e vlerësimit të bashkangjitur me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, e njëjta pretendon po ashtu se lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin paraprak nuk ka pasur ndonjë konsultim siç parashihet me nenin 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë dhe se vlerësimi ndaj saj nuk është bërë në bazë të meritokracisë por në mënyrë arbitrare.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe provave të lëndës, konstaton se bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit del se ankueses i është bërë vlerësimi sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtuesi i Mesme, Ulët dhe Profesionale të datës 15.01.2023 për vitin 2022, i cili është i nënshkruar nga ana e udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankueses mirëpo jo edhe nga ankuesja e që i njëjti mban datën e protokollit me 18.01.2023 sipas shkresës me numër 01 126 e ku ankuesja është vlerësuar me notë të përgjithshme prej 3.1 që nënkupton vlerësimin "mirë". Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të ankueses se e njëjta është vlerësuar sipas dy

formularëve të vlerësimit për rezultatet në punë të vitit 2022 atij të datës 11.01.2023 si dhe 15.01.2023 me nota të ndryshme, Kolegji i Këshillit konstaton se formularët në fjalë të prezantuar nga ana e ankueses me rastin e parashtrimit të ankesës së saj në Këshill, nuk janë të nënshkruar as nga ana e ankueses e as nga ana e Udhëheqëses së saj të drejtpërdrejtë si dhe të njëjtit nuk mbajnë datë të protokollimit, andaj në këtë kuptim Kolegji ka marrë për bazë dhe ka shqyrtuar Formularin për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulët dhe Profesionale të datës 15.01.2023 për vitin 2022, si dokument zyrtar i nënshkruar dhe i protokolluar me rastin e vlerësimit të ankueses, kështu që pretendimet ankimore të ankueses të cilat ndërliidhen me formularët e prezantuar janë të pabazuara dhe jo ligjore.

Referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 43 paragrafit 1 dhe 2, është përcaktuar që: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.* 2. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit”,* ndërsa neni 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcakton se: *“Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)”,* rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në kuadër të objektivave të përcaktuara.

Duke u bazuar në provat e lëndës si dhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, del se ankuesja nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është vlerësuar me notën e përgjithshme prej 3.1, që nënkupton se e njëjta ka arritur të gjitha objektivat në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: 1. *Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”;* ndërsa në kuadër të kuptimit të notave sipas paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të këtij neni, përcaktohet që: *“mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës”.* Andaj bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, 5 paragrafin 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenin 8, nenin 10, nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3, paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, sepse meqenëse ankuesja është vlerësuar me vlerësimin *“mirë”,* rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit të njëjtës nuk i janë cenuar të drejtat për ngritje profesionale dhe ngritje në karrierë në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.345/2023, datë 23/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

